



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.04.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.02.2019
2. Seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, “Mbi prioritetet, si reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut”
3. Të tjera

Marrin pjesë:

Senida Mesi, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Rudina Hajdari, Klodiana Spahiu, Musa Ulqini.

Mungojnë:

Fatmir Velaj, dhe Sadri Abazi.

Të ftuar:

Etilda Gjonaj - Ministre e Drejtësisë

Fjoralba Caka – Zëvendësministre e Drejtësisë

Elda Zenelaj – Drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Integrimin Europian. Sikurse jeni njoftuar, në rendin e ditës kemi këto çështje:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.02.2019, që është dërguar me *e-mail*.

2. Seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, mbi prioritetet në kuadër të procesit të integrimit në BE që, siç e dini janë 5. Më të rëndësishmet prej tyre janë 3 prioritetet: reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut. Këto janë 3 nga 5 prioritetet. Janë përfshirë edhe lufta kundër krimit të organizuar dhe reforma në administratën publike, ku Ministria e Drejtësisë është autoriteti kryesor jo vetëm thjesht si zbatues, por ajo do të raportojë te Kuvendi.

Ju tërheq vëmendjen ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, se jam duke folur!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë dua të mbaroj atë që fillova të them. Do të ta jap fjalën në momentin që do të mbaroj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më ndërprit të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë ju pyeta nëse donit mediet dhe ju nuk ma konfirmuat që i doni mediet.

Ministrja nuk ka ardhur për të tërhequr vëmendjen. Unë do ta shtyj takimin për në një moment të dytë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari - Kjo është një temë shumë e rëndësishme dhe qytetarët shqiptarë duhet ta dinë se çfarë po ndodh. Më vjen keq!

Senida Mesi – Ne kemi takimin e radhës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taulant Balla – ... A mund ta bëjmë mbledhjen pasdite në një orë të përshtatshme edhe për ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – Kolegë, nëse e shtyjmë takimin pasdite në orën 15:30, a mund të merrni pjesë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, do ta shtyjmë, se kemi takimin tjetër, në orën 12:30.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Pas ndërprerjes)

(Rifillon mbledhja)

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Integrimin European. Sikurse jeni njoftuar, në rendin e ditës kemi këto çështje:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.02.2019, që është dërguar me *e-mail*.
2. Seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë, zonjën Etilda Gjonaj për të na raportuar në lidhje me 3 prioritetet shumë të rëndësishme, nga pesë prioritetet që ka Shqipëria për procesin e integritetit europian, që, sikurse e dini, ndër to kemi: reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe dy prioritetet e tjera, që janë lufta kundër krimit të organizuar dhe reforma në administratën publike, për të cilat Shqipëria është zotuar të kryejë reformat për të ecur dhe për të avancuar.

Në kuadrin e miratimit të kalendarit, javën e kaluar kishim në komision ministrin në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Cakaj, ndërsa sot do të kemi ministren e Drejtësisë, zonjën Gjonaj, për të vijuar me ministrin Lleshaj, i cili do të raportojë për prioritetin e luftës kundër krimit të organizuar, si dhe më tutje do të kemi të ftuar përfaqësuesit e Departamentit të Administratës Publike për pjesën e reformës në administratën publike.

Zonja Gjonaj është prezente, së bashku me kolegët e saj, por tërheqim vëmendjen për vonesën në këtë takim, pasi ne po mendonim ta shtynim takimin për sa kohë kishim një konfirmim për pjesëmarrjen tuaj.

Meqenëse takimi po zhvillohet, do t'ju japim kohën tuaj për të raportuar në këtë seancë dëgjimore lidhur me këto tri prioritete shumë të rëndësishme, për të kaluar më pas në diskutimet e kolegëve për pyetje dhe përgjigje.

Zonja Gjonaj, fjala është për ju.

Etilda Gjonaj – Përshëndetje të gjithëve!

Shkurtimisht do të doja që të jepnim disa nga...

(Diskutime në sallë)

Senida Mesi – U lutem medieve të mbajnë qetësi, që të dëgjojmë zonjën Gjonaj!

Po, zonja Gjonaj.

Etilda Gjonaj – Shkurtimisht do të jepja disa nga gjetjet kryesore për sa u përket prioriteteve të Komisionit Europian, që janë pikërisht reforma në drejtësi dhe lufta kundër korrupsionit. Për shkak të zhvillimeve të jashtëzakonshme që kanë ndodhur në vitin 2018 lidhur me këto dy prioritete, risitë, zhvillimet janë të shumta, por unë do të ndalem tek ato më kryesoret, me qëllim që më pas t'u lë vend edhe pyetjeve që anëtarët e komisionit mund të kenë.

Që prej konkluzioneve të Këshillit në qershor të vitit 2018 Shqipëria ka ruajtur dhe thelluar ritmin e procesit të reformës dhe ka konsoliduar pikërisht progresin në përmbushjen e pesë prioriteteve kyçe.

(Diskutime në sallë)

A dëgjohem, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të vazhdoj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Reforma në drejtësi është instrumenti kryesor, që shtyn përpara ecurinë e reformave, veçanërisht atë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kjo dihet tashmë edhe për shkak të asaj çfarë ne presim, që është ngritja e Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe gjykatave të posaçme për krimin e organizuar dhe atyre kundër korrupsionit.

Kjo reformë, ashtu siç e dimë të gjithë, është reforma më gjithëpërfshirëse e ndërmarrë ndonjëherë në Shqipëri. Megjithatë, disa nga arritjet kryesore, të cilat dua t'i ndaj me ju, për sa i përket sistemit gjyqësor dhe reformës në drejtësi vijnë si më poshtë.

Në dhjetor të vitit 2018 u ngritën të dy këshillat, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duke kryer një proces me disa faza, për shkak se të dy këshillat kanë pjesën laike dhe pjesën brenda sistemit, por të dy këshillat, ashtu siç përcaktonte Kushtetuta dhe ligjet, duhet të ngriheshin dhe të bëheshin funksionalë në momentin edhe kur anëtari i fundit ishte emëruar.

Prandaj në dhjetor të vitit 2018 të dy këta këshilla u ngritën dhe sot kanë kryer një sërë procesesh lidhur me pjesën e funksionimit të tyre.

Për sa i përket pjesës së veprimtarisë që kryejnë komisionet e pavarura të vetingut, procesi ka ecur me ritme të mira dhe, njëkohësisht, ka pasur rezultate. Deri në datën 11 mars

numri i vendimeve ka qenë 110, ndërkohë që pas kësaj periudhe ka avancuar dhe numri i tyre ka shkuar deri në 120, por për të qenë korrektë pikërisht edhe në informacionin që ne kemi shpërndarë, po i referohem informacionit deri në datën 11 mars, ku 50 vendime kanë qenë për konfirmimin në detyrë të gjyqtarëve, 44 vendime kanë qenë për shkarkimin nga detyra, ndërkohë që 16 vendime janë për dorëheqje.

Ditët e sotme, ashtu siç ju thashë për pjesën e përditësimit të informacionit numri i tyre ka shkuar në 20. Duke mbajtur në konsideratë se procesi i vetingut është një nga proceset më të rëndësishme për sa i përket pastrimit të pallatit të drejtësisë nga gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar. Ky është një proces, i cili po ndiqet me shumë vëmendje edhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit tashmë, i cili është pjesë e këtij procesi, po ndiqet edhe nga e gjithë pjesa e ndërkombëtarëve mënyra se si po ecën çështja e vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Disa risi që kanë ndodhur, ashtu siç jeni në dijeni, qeveria shqiptare ka dhënë të gjithë mbështetjen për zbatimin e reformës në drejtësi, kjo jo vetëm në aspektin e infrastrukturës, ku në vitin 2018 Kolegji i Apelit filloi funksionimin e tij në ambientet e reja të cilat u vunë në dispozicion nëpërmjet investimit që kreu qeveria nëpërmjet buxhetit të shtetit, por gjithashtu edhe një sërë nismash të tjera që kanë të bëjnë me aspektet financiare që iu dhanë procesit të vetingut dhe institucioneve të tjera, që ka të bëjë me pajisjet e teknologjisë së informacionit për Kolegjin e Apelit, të cilat shkojnë në vlerën 41 milionë. Po të mbajmë në konsideratë infrastrukturën që përmenda pak më parë në shifra, rreth 110 milionë lekë, kjo vetëm për t'u dhënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme këtyre institucioneve për të kryer veprimtarinë e tyre.

Tashmë e dimë që më 1 janar të vitit 2019 pagat e gjyqtarëve janë dyfishuar pasi skema e re e pagës është futur në fuqi. Kjo bën që i gjithë fondi që qeveria shqiptare e kishte buxhetuar për t'ia dhënë pjesës së skemës së sistemit të drejtësisë, aktualisht është në fuqi. Tashmë nuk janë thjesht vetëm shifra, për të cilat ne do të japim mbështetjen, por këto shifra janë realitet, pasi skema e pagave për gjyqtarët dhe prokurorët dhe të gjithë subjektet e parashikuara me ligjet e paketës së reformës në drejtësi është një skemë, e cila po aplikohet. Për të mos harruar mbështetjen financiare që qeveria i ka dhënë me buxhetin e saj pagës, pagesës ekstra që anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit apo komisionerët publikë, anëtarët e Kolegjit të Apelit kanë marrë në kuadër të rritjes së kësaj pagese me 50%, me vendim të Këshillit të Ministrave mbi pagën që atyre u është përcaktuar me ligj.

Të njëjtat iniciativa po ndërmarrim edhe për proceset e tjera. Sot jemi në procesin e plotësimit të vakancave të Gjykatës Kushtetuese, ku Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i

zgjedhur nga Kuvendi nëpërmjet shortit të anëtarëve të tij ka filluar funksionimin që në janar të vitit 2019. Ata kanë kryer një sërë veprimtarish që e kanë raportuar edhe në kuadër të mekanizmit monitorues të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë të ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë si koordinatori kryesor i kësaj strategjie dhe planit të veprimit përkatës. Ka rezultuar që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka kryer një sërë veprimesh në miratimin e rregulloreve dhe ka filluar funksionimin e saj. Ajo që është shumë e rëndësishme për t'u përmendur ka shpallur thirrjen për inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe shumë shpejt pasi KED-ja të kryejë të gjithë procesin e verifikimit apo dhe të rankimit të kandidatëve për inspektor të lartë të drejtësisë, inspektori i Lartë i Drejtësisë do të arrijë të zgjidhet nëpërmjet procedurave siç është përcaktuar nga ligji, është Kuvendi që e miraton me shumicë të cilësuar.

E njëjta situatë është edhe për progresin që ne kemi arritur në kuadër të plotësimit të vendeve vakante të Gjykatës Kushtetuese. Kur them ne, këtë e them si një koordinator për zbatimin e reformës në drejtësi, por KED-ja ka kryer të gjithë procesin, pasi janë hapur thirrjet nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, nga parlamenti, KED-ja ka kryer të gjithë procesin për plotësimin e dokumentacionit dhe është në procesin e verifikimit të kandidaturave për vendet vakante sipas çdo pozicioni që është shpallur nga Presidenti dhe nga parlamenti.

Nga ana tjetër, kemi në proces paralel edhe procesin për ngritjen e Prokurorisë së Posaçme. Këshilli i Lartë të Prokurorisë ka hapur thirrjen për plotësimin e vakancave dhe për të thirrur kandidatët që duan të aplikojnë për SPAK-un, Prokurorinë e Posaçme. Tashmë, ky proces është në vazhdimësi në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ku jo vetëm kanë arritur të hartojnë dhe miratojnë rregulloret, në lidhje me mënyrën se si do të bëhet rankimi i kriterëve profesionale, të meritës, e njëkohësisht edhe integriteti i figurës së kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme.

Në të njëjtën situatë është edhe Gjykata e Posaçme, e cila në fakt ka një rregullim ligjor ndryshe, por Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer gjithë veprimtarinë, me qëllim që në momentin kur të ngrihet SPAK-u, Prokuroria e Posaçme, edhe Gjykata e Posaçme të jetë funksion.

Pra, siç e vini re, nga të gjitha institucionet e reja, të cilat ishin planifikuar të ngriheshin, disa prej tyre janë ngritur, ndërsa pjesa tjetër janë ende në proces. Unë besoj fort se deri në qershor të vitit 2019 ne do ta kemi Gjykatën Kushtetuese të plotësuar, me qëllim që ata të arrijnë kuorumin për të pasur vendimmarrje në lidhje me proceset dhe kërkesat që kanë shkuar pranë Gjykatës Kushtetuese. Njëkohësisht do të kemi edhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Nga ana tjetër, SPAK do të jetë një institucion i cili gjithashtu do të arrijë të ketë kandidatët e parë të vetuar, me qëllim që funksionimi të fillojë sa më parë, sipas parashikimeve ligjore.

Ndërkohë, edhe qeveria po mendon për pjesën e paketës së disa ligjeve, të cilët kanë qenë pjesë e paketës së reformës në drejtësi, por që kanë mbetur ende pa miratuar. Gjatë vitit 2018 kanë kaluar një sërë ligjesh të tjera, pra nga paketa e 27 projektligjeve, si ligji për profesionin e avokatit, për noterin, për avokaturën e shtetit, për disa ndryshime dhe shtesa për ekzekutimin e vendimeve penale, e njëkohësisht edhe ligji për ndërmjetësin.

Janë akoma në proces diskutimi, nga deputetët nëpër komisionet përkatëse, tre projektligje: “Për organizmin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, “Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë”, si dhe “Për disa ndryshime në ligjin për përmbarimin gjyqësor privat”.

Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë ka përgatitur gjithë paketën e akteve nënligjore për zbatimin e paketës së reformës në drejtësi. Renditen dhjetë akte nënligjore, të cilat tashmë janë bërë gati që në gushtin e vitit 2018, dhe janë diskutuar me të gjithë partnerët ndërkombëtarë, me gjithë aktorët vendës e të tjerë, por janë shtyrë në vendimmarrje, kjo edhe me sugjerimin e aktorëve ndërkombëtarë, partnerëve tanë, me qëllim që kjo paketë të konsultohet edhe me të dy këshillat që u ngritën. Prandaj, me ngritjen e këtyre dy këshillave, kjo paketë ka kaluar në një konsultim më të gjerë, dhe shumë shpejt, brenda muajit prill, pritet që e gjithë paketa, me dhjetë aktet nënligjore të miratohet në Këshillin e Ministrave, për ta bërë funksionale çdo lloj veprimtarie që lidhet me pjesën e zbatimit të reformës në drejtësi.

Nga ana tjetër, pavarësisht se është pjesë e strukturave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, do të kërkoja gjithashtu edhe mbështetjen tuaj, me qëllim që të dy ligjet e mbetura pa miratuar, me ndryshimet që ka diktuar Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj për dy ligjet e paketës së reformës në drejtësi. Do ta çmoja vërtetë shumë të rëndësishme, e jo vetëm unë si ministre drejtësie, si koordinator kryesor për zbatimin e reformës në drejtësi, por njëkohësisht, edhe nga partnerët ndërkombëtarë, edhe nga institucionet që sot kanë filluar të funksionojnë, për ta miratuar sa më shpejt këtë paketë, e cila është përgatitur edhe në bashkëpunim me ndërkombëtarët, si arsye e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që shfuqizonte disa dispozita në ligjin “Për statusin e magjistratit” dhe në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Për sa i përket asaj çfarë ne kemi ndërmarrë dhe asaj se çfarë po bëjmë tjetër, është se gjatë vitit 2019, gjatë këtij tremujori të parë, kemi përgatitur dhe po shikojmë edhe mundësinë e incentivimit financiar të prokurorëve që do të jenë pjesë e SPAK-ut, me qëllim që të kenë një

diferencë në ligj, po për të pasur një incentivime edhe për ata kandidatë që do të kalojnë procesin e vetingut dhe do të shërbejnë në organin e prokurorisë. Ky është i prokurorisë së posaçme.

Kjo është një iniciativë e që Ministria e Drejtësisë po e përgatit bashkë me partnerët ndërkombëtarë me qëllim që të kalojë sa më shpejt në mbledhje dhe të miratohet nga qeveria shqiptare.

Lidhur me pjesën e antikorrupsionit, luftën kundër korrupsionit, ministri i Drejtësisë si koordinator kombëtar i antikorrupsionit ka marrë një sërë masash dhe kjo pikësëpari lidhet me miratimin e planit të veprimit nga qeveria shqiptare në prill të vitit 2018, për parandalimin e korrupsionit, por duke u ndalur në dy drejtime:

Drejtimi i parë ka të bëjë me pjesën e parandalimit, ku nuk është e përfshirë vetëm Ministria e Drejtësisë apo qeveria, pushteti qendror, por janë të përfshira edhe institucionet e pushtetit vendor dhe institucionet e pavarura si pjesë e këtij plani veprimi.

Risia që solli plani i veprimit për vitin 2018 është, së pari, se u ul numri i masave për ta bërë atë sa më realist si plan.

E dyta, u përfshinë ato institucione që kishin një perceptim dhe një efektshmëri më të lartë për parandalimin e korrupsionit.

E treta, në planin e veprimit u përfshi edhe ngritja e task forcës antikorrupsion, e cila do të merrte masa represive në rastet e gjetjes së shkeljeve, abuzimeve apo rastet e korrupsionit kur kryheshin inspektimet administrative po nga kjo task forcë.

Po në prill të vitit 2018, KM-ja me vendim të tij, vendosi ngritjen në një nivel politik edhe të monitorimit të zbatimit të planit të veprimit antikorrupsion, duke vendosur dhe duke përcaktuar ngritjen e komitetit koordinues, i cili drejtohet nga ministri i Drejtësisë si koordinatori kombëtar antikorrupsion dhe në përbërje të tij ka nga një zëvendësministër për çdo ministri, i cili përgjigjet dhe është përgjegjës për zbatimin e të gjitha masave në varësi të asaj çka parashikon plani i veprimit dhe që ka në kompetencë lëndore dhe përgjegjësi lëndore secila ministri, me qëllim që zbatimi i saj të mos ngelet thjesht në nivel teknik, por të jetë në nivel politik.

Nga ana tjetër, ashtu s'është thashë, është përcaktuar ngritje e task forcës po në prill të vitit 2018 dhe vetëm për 2018 – 2010 shifrat e task forcës tregojnë se janë monitoruar 80 institucione nga maji 2018, kur është ngritur Task Forca Antikorrupsion si një task forcë ndër institucionale, ku janë rekomanduar 396 masa administrative, 544 masa disiplinore, prej të cilave 110 janë largime nga shërbimi civil ose nga pozicione të tjera, të cilat mund të jenë me kontratë pune dhe 36 punonjës janë të penalizuar penalisht në organin e akuzës,

Një aspekt pozitiv që keni pasur për Task Forcën Antikorrupsion është se jo vetëm kemi arritur të marrim masa represive, por, përveç pjesës së publikimit të gjetjeve dhe ndarjes edhe me aktorët e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë ose ata që na mbështetin në mënyrë të vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit, ka qenë edhe një njohje e rezultateve edhe nga Komisioni Europian apo nga struktura të tjera, të cilat kanë njohur pikërisht rezultatet që Task Forca Antikorrupsion ka arritur.

Ndërkohë, edhe nëpërmjet reformës në drejtësi, edhe nëpërmjet masave parandaluese që qeveria shqiptare ka miratuar me planin e veprimit, për të cilin ka një monitorim periodik, ashtu edhe me Task Forcën Antikorrupsion, duke parë këto tre drejtime, do të jetë pikërisht lufta kundër korrupsionit, e cila do të arrijë të ketë një rezultat shumë më sinjifikativ.

E fundit që doja të theksoja, pavarësisht se nuk është pjesë e përgjegjësisë së drejtpërdrejtë të ministrit të Drejtësisë, ka të bëjë me një përpjekje të vazhdueshme të organit të akuzës dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese, të cilat kanë bërë në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar, e njohur tashmë edhe nga Komisioni Europian, ku një ndër rezultatet kryesore të arritura në vitin 2018 është pikërisht nënshkrimi i marrëveshjes EuroJust dhe ratifikimi i saj në një kohë shumë të shkurtër, për fatin e mirë, nga Kuvendi, e cila do ta bëjë Shqipërinë që të përcaktojë një prokuror të posaçëm në Hagë, me qëllim që të kryhen hetime të përbashkëta së bashku me kolegët e tjerë të vendeve të tjera europiane. Vullneti që ka pasur qeveria shqiptare dhe Kuvendi për ta ratifikuar këtë marrëveshje, si dhe angazhimi për ta vënë në zbatim, që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi menjëherë, është një aspekt pozitiv, i cili është njohur edhe nga Komisioni Europian. Këto kisha për të përmendur, nëse ka pyetje, mund të përgjigjem për çështje specifike.

Faleminderit!

Senida Mesi – Zonja Ministre, të falënderoj për përmbledhjen!

Në fakt, tematikat janë të gjëra dhe besoj se nuk mjaftojnë gjysmë ore ose edhe pak më gjatë për diskutimin e tyre. Këto janë tematika që do të donim t'i diskutonim edhe në vijim dhe për këtë arsye ju ftuam që të na bënit edhe një përmbledhje.

Dua t'ua kaloj fjalën kolegëve të nderuar lidhur me këto tri reforma të rëndësishme.

Fjalën e ka zonja Hajdari.

Rudina Hajdari – Zonja Ministre, faleminderit shumë për prezantimin!

Kam disa pyetje.

Ju folët për reformën në drejtësi, por, siç e dini, një nga kërkesat themelore të Bashkimit Europian është lufta ndaj korrupsionit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, që ju nuk i prekët fare në prezantimin që bëtë. Unë kam pyetje që lidhen pikërisht me këto dy sfida:

korupsionin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që, në fakt, përfshijnë dy gjëra: mbrojtjen e të drejtave të pakicave, por edhe të drejtave të pronave.

Sfida e korupsionit, e cila ka 28 vjet që ka mbërthyer Shqipërinë, në 5 vjetët e fundit ka pasur një rritje jashtëzakonisht shumë të madhe, duke marrë parasysh edhe rritjen e kriminalitetit në Shqipëri. Raporti i fundit për të drejtat e njeriut i Departamentit Amerikan të Shtetit thotë: “Korrupsioni në Shqipëri është i përhapur në të gjitha degët e qeverisë dhe evidentohet që është pengesa kryesore në luftën kundër narkotrafikut”. Shprehimisht në raport thuhet se institucionet tona janë modestisht të pajisura për të luftuar krimin e organizuar dhe korupsionin në çdo nivel të qeverisjes, e cila kufizon efektivitetin e përgjithshëm të këtyre institucioneve për të luftuar këto fenomene.

Këtë vit kemi pasur kriminalitet të madh dhe korupsion galopant në qeverisjen shqiptare, në çdo degë dhe nivel të saj, gjë që theksohet në çdo raport për Shqipërinë, a mund të thoni se si me një task forcë, që keni ngritur, keni arritur të bëni përmirësime në korupsionin brenda institucioneve dhe në luftën kundër trafikimit të drogës?

Ju lutem, përgjigjuni të gjitha pyetjeve, sepse janë me interes të madh publik.

Pyetja e dytë lidhet me të drejtën e pronës. Siç e dini edhe ju, e drejta e pronës është një e drejtë themelore, e cila duhet të respektohet si e drejta më themelore e të drejtave të njeriut. Kemi disa vjet që trajtimin e pronave, sidomos kompensimin e pronave, apo mënyrës sesi ne i trajtojmë qytetarët tanë, ka qenë një panoramë, për të cilën besoj se asnjë nuk mund të jetë krenar për të.

Zonjë, çfarë keni bërë ju vitin e fundit për sa i përket kësaj sfide, sepse është përmendur në të gjitha raportet dhe është kërkesë e Bashkimit Europian?! Pra, të gjitha kërkesat që shkojnë nëpër gjykata, shkojnë në Gjykatën e Strasburgut, sepse nuk marrin asnjë lloj përgjigjeje nga institucionet tona. Pra, është një sfidë shumë e rëndësishme dhe ju nuk e prekët fare.

Pyetja e tretë dhe shumë e rëndësishme, por nuk e di sa mund të më përgjigjeni, mendoj se duhet të keni një kompetencë për këtë gjë, sepse jeni ministre e Drejtësisë. Më duhet të them se, siç e dini, zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 ishin zgjedhje shumë problematike, kjo është konstatuar shprehimisht në raportin e OSBE-ODIHR-it, po ashtu u theksua edhe në raportin e DASH-it, që këto zgjedhje kishin fenomenin e shitblerjes së votës. Domethënë, jo vetëm shitblerja e votës, por edhe presion mbi zgjedhësit, si dhe parregullsi edhe brenda administratës. Zonja Ministre, dua të di si do të veprojë Ministria e Drejtësisë në zgjedhjet e ardhshme? Pra, a do ta merrni ju këtë lloj kompetence dhe a do të merrni ju masa parandaluese

për këto fenomene negative, që do t'u sigurojnë shqiptarëve zgjedhje të lira dhe të ndershme?
Si Ministri e Drejtësisë, a ndjeni përgjegjësi për këtë?

Faleminderit!

Senida Mesi – Kolegë, a keni pyetje të tjera? Nuk ka.

Atëherë fjala për ju zonja Ministre.

Etilda Gjonaj – Po i marr me radhë pyetjet që bëri zonja deputete.

Në prezantimin që bëra u ndala te dy përgjegjësitë kryesore që ka Ministria e Drejtësisë për sa u përket prioritetëve të BE-së, te reforma në drejtësi dhe te lufta kundër korrupsionit. Kontributore Ministria e Drejtësisë është edhe te prioriteti i pestë, që janë të drejtat e njeriut, por duke pasur në konsideratë kohën e kufizuar dhe për t'u lënë kohë pyetjeve, mendova ta prek kur ju të bënit pyetjet.

Ministria e Drejtësisë tek të drejtat e njeriut është kontributore në disa sektorë, jo vetëm në të drejtën e pronës, por në pjesën e trajtimit human të personave në sistemin penitenciar, ashtu si dhe në një sërë çështjesh të tjera, që kanë të bëjnë me pjesën e të drejtave të fëmijëve. Ndërkohë, ne kemi investuar, për shkak edhe të zbatimit të reformës në drejtësi, në një sistem totalisht të ri, rehabilitues dhe riintegrues të fëmijëve ose të miturve në kontakt me organet e drejtësisë. Njëkohësisht, ajo që është investuar fort edhe nga partnerët ndërkombëtarë ndihma juridike, është krijuar tërësisht një skemë e re. Ministria e Drejtësisë ka ndjekur me përgjegjësi jo vetëm pjesën e miratimit të një sërë aktesh që rrjedhin si detyrim i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, ashtu si edhe ligji “Për ndihmën juridike”, por, nga ana tjetër, duke ngritur institucionet e qëndrueshme, të cilat do të bëjnë pikërisht zbatimin e këtyre ligjeve.

Së pari, për të ofruar aksesin e qytetarëve në organet e drejtësisë, duke u ofruar ndihmë juridike parësore dhe dytësore një numri shumë të lartë individësh dhe, njëkohësisht, një numri apo një kategori, të cilët tashmë janë përcaktuar në ligj, që e përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pikërisht do të jetë një drejtori e ndihmës juridike, që është ditë duke u ngritur këto ditë, ku së bashku me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe me dhomat lokale do të ofrojë dhe do të garantojë menaxhimin e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Nuk po ndalem te ato që Ministria e Drejtësisë ka bërë gjatë vitit 2018, si iniciativa kryesore për ngritjen e disa zyrave në disa bashkoi për sa i përket ofrimit të ndihmës juridike parësore; nuk po ndalem as te fakti se çfarë ka bërë Ministria e Drejtësisë në zbatimin e detyrimeve ligjore për Kodin e Drejtësisë për të Miturit, ku ka ndryshuar tërësisht sistemin, duke ofruar një drejtësi miqësore për ta, duke nënshkruar deri tani 10

(Ndërpritet incizimi.)

MBYLLET MBLEDHJA